- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

#### Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njojhe e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

#### Neni 30 Shkaqe për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- Parapagimi vonohet.
- Menaxheri i Projektit pa arsyë të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbrushje të kontratës.
- Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKET**

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

### **Neni 32 Testet përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvjetorë tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkufizuar me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkoen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinnovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinnovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinnovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërpërjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rrreshth pa qenë e përfshirë kjo ndërpërje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;

- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsy e tjetër të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e konratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e konratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të konratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e konratës paraqet bazë për shkëputje të konratës.

37.4 Nëse për shkak të fajt të palës së tretë krijuhen rrëthana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të konratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### Neni 38                  **Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrrregullimet industriale, çrrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërvshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me konratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësítë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iii. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të konratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- iv. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësítë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e konratës.

### Neni 39                  **Pagesa pas shkëputjes së konratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të konratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxhi ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të konratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

**Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkoħshme, dhe Punët do tē konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet pér shkak tē gabimit tē Kontraktuesit.

**Neni 41 Lirim i Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit tē Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do tē vërtetoj këtë. Kontraktuesi do tē siguroj vend punimin dhe do tē ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit tē këtij vërtetimi dhe do tē paguhet pér punët e kryera para pranimit tē tij dhe pér punët e kryera më pas pér tē cilat është arritur marrëveshje.

**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE****Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë tē gjitha përpjekjet pér tē zgjidhur në mënyrë miqësore tē gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim pér pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe pér ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh tē dobishme, palët do tē takohen dhe tē mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do tē i përgjigjet kérkesës pér zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kérkesës. Periudha maksimale që jepet pér arritjen e kësaj zgjidhjeje do tē jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja pér tē arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon tē përgjigjet me kohë ndaj kérkesave pér zgjidhje, tē dyja palët do tē jenë tē lira tē vazhdojnë në fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore tē mosmarrëveshjes dështon, palët mund tē merren vesh tē përiqen tē pajtohen përmes institucionit tē specifikuar në KVK. Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit tē procedurës së pajtimit, secila palë do tē ketë tē drejtë tē vazhdojë në fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore pér zgjidhje tē mosmarrëveshjes, secila palë mund tē kérkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin pér mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-24-8060-5-2-1/C988

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhëne, sipas nevojës, në shenimet kurative të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>[shëno gjuhen e procedurës]</b> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>shumë fiks prej 1500.00€ në kohëzgjatje prej 60 ditë</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të janë në përpunë me dispozitat e kontratës sipas kërkave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p style="text-align: center;">e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit të <b>ekzekutimi do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 30 ditë kalendarike pas fillimit të punëve, rrespektivisht 19.10.2024.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës</b> për ditë.
		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është


		<i>[10% e Çmimit final të Kontratës.</i>
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishtë nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>Kushtrim Jashanica ndersa MDMK caktohet Armend Aliu</i>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>nuk do të ketë parapagim</i>
Pagesa	26.2	Pagesa do të kryhen sipas situacioneve të përfunduara në terren dhe të pranuara nga menaxheri i kontratës, me raport.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <i>/shëno përgjindjen/</i>
Shkaqet përkompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <i>/shëno numrin/</i> ditë
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Ndermjetesim prane Ministritë se Drejtësise
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>glykata themelore e vendit</i> në pajtim me ligjin në Kosovë ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës</i> në kuadër të <i>Odës Ekonomike të Kosovës</i>, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p>

# PARAMASA DHE PARALLOGARIA

LOKACIONI: LIPJAN

## VËREJTJE:


Materialet e propozuara në përshkrim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për karakteristikat e materialeve që duhet të përdoren andaj të gjitha ato mund të zëvendësohen me materiale të prodhuesve tjerë me karakteristika të njëjtë ose më të mira që duhet dëshmuar me çertifikatat apo atestet e ofruara nga prodhuesit respektiv. Ne te gjitha pozicionet perfshihet FURNIZIMI DHE MONTIMI/PUNIMI I ATIJ POZICIONI. TEK PASTRIMET, DEMOLIMET E GERMIMET TE PERFSHIHET EDHE TRANSPORTI DERI NE DEPONI. Per çdo ndryshim eventual te meret paraprakisht aprovimi nga projektuesi.

A.	OBJEKTI 1				
1	PUNET E RRENIMIT - OBJEKTI 1				
1.01	PUNET PARAPREGADITORE				
					
POS	PËRSHKRIMI I PUNEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI/NJESI	SHUMA
1.01.01	Pergatitja e kompanise dhe bartja e paisjeve qe mundesojne realizimin e punimeve ne vendpunishte. Ne cmim te perfshihet dhe sigurimi I vendpunishtes per realizimin e punimeve ne menyren me te sigurte (rrethimi i punishtes). Ne cmim perfshihet punimi dhe vodosja e tabelave informuese.	m'	300.00	3.00 €	900.00 €
1.01.02	Te behet shkyqja nga kyqjet ekzistuese (rrjeti elektrik si dhe nga rrjeti hidrosanitar/kanalizim), ne cmim perfshihe njoftimi I kompanive per gjegjese dhe perfillja e procedurave adekuate.	komplet	1.00	20.00 €	20.00 €
1.01.03	Te behet demotimi I shenjave ekzistuese te cilat pas perfundimit do te kthehen ne pozicionin paraprak, ne cmim jane te perfshira betonimi I bazamentit te tyre pas perfundimit te punimeve dhe kthimi ne vendet e veta(zhvendosja te behet me pelqimin e zyrtarit per gjegjes per komunikacion)	cope	2.00	100.00 €	200.00 €
		TOTAL POZICIONI	1.01	1,120.00 €	

1.02	PUNET E DEMOLIMIT				
POS	PËRSHKRIMI I PUNEVE				
1.02.01	Te behet rrenimi I objektit me dimensione 24 x 15 me forme te regullt drejt kendeshe te bazes (me sipërfaqe totale te bazes 360 m <sup>2</sup> me etazhitete P+NK I punuar me themelplak beton te armuar dhe me dysheme te nenkuqmiot me llaq dhe ndarje te mureve me tulla te plota. Ne cmim perfshihet rrenimi I te gjithe materialete duke perfshire dhe themellet e objektit me te gjitha shtresat. Te gjitha materialet e objektit qe rrenohet janë per gjegjesi e kompanise kontraktuese per asgjesim dhe hudhje	cope	1.00	4,000.00	4,000.00
1.02.02	Ne kete pozicion perfshihen 5% e puneve te pa parapara te cilat mund te shfaqen gjatë realizimit te demolimit te objektit. Te meret 5% e pos 1.02.01	%	0.05	4,000.00	200.00
		TOTAL POZICIONI	1.02	4,200.00 €	

<b>1.03</b>	<b>PUNËT E NDRYSHME</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI</b>	<b>TOTAL</b>
<b>POS</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNËVE</b>				
1.03.01	Furnizimi me material si dhe mbushja e gropes ndertimore te themeleve me zhavor 0-63mm kualitativ cilesore. Ne cmim perfshihet shtrirja, rrafshimi dhe ngjeshja me cilinder adekuat 8 tonsh.	m <sup>3</sup>	108.00	10.00 €	1,080.00 €
1.03.02	Te behet pastrimi I hapsires si dhe largimi mbetjeve tjera ndertimore dhe te behet pergaditja per pranim dorezim. Te jetet tereni/zona e nivelizume e pastrume dhe e trajtume si duhet.	komplet	1.00	50.00 €	50.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>			<b>1.03</b>	<b>1,130.00 €</b>	

<b>PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 1</b>			
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE		1,120.00 €
1.02	PUNËT E DEMOLIMIT		4,200.00 €
1.12	PUNËT E NDRYSHME		1,130.00 €
<b>PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 1</b>			<b>GJITHSEJT</b>
			<b>6,450.00 €</b>



<b>1</b>	<b>PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 2</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI</b>	<b>SHUMA</b>
<b>1.01</b>	<b>PUNËT PARAPREGADITORE</b>				
<b>POS</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNËVE</b>				
1.01.01	Te behet shkyqja nga kyqjet ekzistuese (rrjeti elektrik si dhe nga rrjeti hidro-sanitar/kanalizim), ne cmim perfshihe njoftimi I kompanive perjegjese dhe perfillja e procedurave adekuate.	komplet	1.00	20.00 €	20.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>			<b>1.01</b>	<b>20.00 €</b>	

<b>1.02</b>	<b>PUNËT E DEMOLIMIT</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>	<b>ÇMIMI/NJËSI</b>	<b>SHUMA</b>
<b>POS</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNËVE</b>				
1.02.01	Te behet rrenimi 1 objekteve me dimensione 28 x 5 si dhe objekti 12 x 9 m me siperfaqe totale te bazave 248 m <sup>2</sup> . Ne cmim perfshihet rrenimi I te gjithe materialete duke perfshire dhe themelet e objektit me te gjitha shtresat. Te gjitha materialet e objektit qe rrenohet jane perjegjesi e kompanise kontraktuese per asgjesim dhe hudhje Transporti i mbeturinave deri ne deponi.	cope	1.00	3,500.00	3,500.00
1.02.02	Ne kete pozicion perfshihen 5% e puneve te pa parapara te cilat mund te shfaqen gjate realizimit te demolimit te objektit. Te meret 5% e pos 1.02.01	%	0.05	3,500.00	175.00
1.02.03	Furnizimi shtrirja dhe ngjeshja e materialit guror 0-63mm, ngjeshja me cilinder adekuat 8 tenosh ne themelet e objektit ku eshte bere rrenimi	m <sup>3</sup>	74.40	10.00	744.00

1.02.04	Te behet pastrimi I hapsires si dhe largimi mbetjeve tjera ndertimore dhe te behet pergaditja per pranim dorezim. Te jetet tereni/zona e nivelizume e pastrume dhe e trajtume si duhet.	Komplet	1.00	50.00	50.00
		<b>TOTAL POZICIONI</b>			<b>4,469.00 €</b>

<b>PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 2</b>		
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE	20.00 €
1.02	PUNËT E DEMOLIMIT	4,469.00 €
<b>PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 2</b>		<b>GJITHSEJT</b>
		<b>4,489.00 €</b>

<b>REKAPITULLIM I TË GJITHA FAZAVE</b>		
1	PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 1	6,450.00 €
2	PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 2	4,489.00 €
		<b>GJITHSEJT ME TAKSA</b>
		<b>10,939.00 €</b>

## **PARAMASA DHE PARALLOGARIA**

**LOKACIONI: SHALE**

VEREJTJE:

Materialet e propozuara në përshtkim teknik dhe paramasë janë opcionale dhe pikë referimi për



<b>A. OBJEKTI 1</b>					
<b>1. PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 1</b>					
<b>1.01 PUNËT PARAPREGADITORE</b>					
<b>POS</b>	<b>PERSHKIMI I PUNEVE</b>	<b>NJESTA</b>	<b>SASTA</b>	<b>ÇMIMI/NJESTI</b>	<b>SHUMA</b>
1.01.01	Pergatitja e kompanise dhe bartja e paisjeve qe mundesojne realizimin e punimeve ne vendpunishte. Ne cmim te perfshihet dhe sigurimi I vendpunishtes per realizimin e punimeve ne menyren me te sigurte (rrethimi i punishtes). Ne cmim perfshihet punimi dhe vodosja e tabelave informuese.	m'	90.00	3.00 €	270.00 €
1.01.02	Te behet shkyqja nga kyqjet ekzistuese (rrjeti elektrik si dhe nga rrjeti hidroasanitar/kanalizim), ne cmim perfshihe njoftimi I kompanive perjegjese dhe perfillja e procedurave adekuate.	komplet	1.00	20.00 €	20.00 €
		<b>TOTAL POZICIONI</b>	<b>1.01</b>		<b>290.00 €</b>

<b>1.02</b>	<b>PUNËT E DEMOLIMIT</b>	<b>NJESIA</b>	<b>SASTA</b>	<b>ÇMIMI/NJESIA</b>	<b>SHUMA</b>
<b>POS</b>	<b>PERSHKIMI I PUNEVE</b>				
	Te behet rrenimi I objektit me dimensione 11.3m'x10 m' me forme te regullt drejtkencheshe te bases (me siperfaqe te				
1.02.01	Demolimi I kulmit ,pjesa e nenkulmit dhe te gjitha materialeve dhe demolimi I pllakes se perdheses	cope	1.00	250.00	250.00
1.02.02	Demolimi I te gjitha mureve te brendshe dhe perimetrike,dyereve dhe dritareve dhe ye gjiths materialeve tjera si dhe demolimi I pllakes se themelit me te gjitha shtresat	cope	1.00	400.00	400.00
1.02.03	Ne kete pozicion perfshihen 10% e puneve te pa parapara te cilat mund te shfaqen gjate realizimit te demolimit te objektit. Te meret 10% e pos 1.02.02	%	0.10	400.00	40.00

	<b>TOTAL POZICIONI</b>	<b>1.02</b>	<b>690,00 €</b>
--	------------------------	-------------	-----------------

<b>1.03</b>	<b>PUNË E NDRYSHME</b>	<b>NJËSTIA</b>	<b>SASTIA</b>	<b>CMIMI/NJËSTI</b>	<b>TOTAL</b>
<b>POS</b>	<b>PERSHKIRMI I PUNËVE</b>				
1.03.01	Furnizimi me material si dhe mbushja e gropes ndertimore me "DHE" kualitativ cilesore per mbjellje te vegjetacionit te larte dhe te ulet. Ne cmim perfshihet shtrirja, rrafshimi dhe pastrimi nga guret dhe mbetjet e materialit ndertimore.	m <sup>3</sup>	75.00	2.00 €	150.00 €
1.03.02	Furnizimi dhe mbjellja e barit holandez ne siperfaqen e parceles,te behet frezimi,rrafshimi dhe pastrimi I terenit nga mbetjet,largimi I mbeturinave te ngurta,mbjellja e barit dhe ngesha me cilinder.	m <sup>2</sup>	300.00	0.50 €	150.00 €

1.03.03	Furnizimi,transporti,hapja e gropave dhe mbjellja e fidaneve catalpa,lartesia e drurit nga toka deri ne degzimet e para te jete 2 m me kurore te formuar deri ne 2.3-2.5 m lartesi.Trashesia e trungut deri ne 1 m lartesi te jete me perimetër deri 16-18 cm.Druri duhet te jet i kultivuar mire ne vazo me dhe te mire humusor.(Vendi i mbjelljes caktohet nga organi mbiqyres)	cope	10.00	23.00 €	230.00 €
1.03.04	Te behet pastrimi I hapsires si dhe largimi mbetjeve tjera ndertimore dhe te behet pergaditja per pranim dorezim. Te jete tereni/zona e nivelizume e pastrume dhe e trajtume si duhet.	komplet	1.00	50.00 €	50.00 €
<b>TOTAL POZICIONI</b>				<b>1.03</b>	<b>580.00 €</b>



<b>PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 1</b>			
1.01	PUNËT PARAPREGADITORE		290.00 €
1.02	PUNËT E DEMOLIMIT		690.00 €
1.12	PUNËT E NDRYSHME		580.00 €
			<b>1,560.00 €</b>
1	PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 1		6,450.00 €
2	PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 2		4,489.00 €
3	PUNËT E RRENIMIT - OBJEKTI 3		1,560.00 €
	shuma e përgjithshme me TVSH		<b>12,499.00 €</b>

  
 MODEL  
 INVEST  
 GROUP  
 SH.P.K.  
 LIPJAN

## KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

# NJOFTIM PËR KONTRATË

**PUNË**

**FURNIZIM**

**SHËRBIME**

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 05.08.2024

Nr i Prokurimit	613-24-8060-5-2-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



## NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN		
Adresa Postare: SHQIPERIA		
Qyteti: LIPJAN	Kodi postar: 14000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Bekim Shabani		Telefoni: 038 200 41539
Email: bekim.g.shabani@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

Po  Jo

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po  Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoritetave Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

## NENI II: LËNDA E KONTRATËS

## II.1) PËRSHKRIMI

### II.1.1) Titull i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:

Rrënimi i objekteve të vjetra te tregu i gjelbër në Lipjan dhe rrënimi i objektit të vjetër të QMF-së në Shalë

### II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit

(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës sua)

<input checked="" type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input type="checkbox"/> Shërbime
<input checked="" type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit tregu i gjelbër në Lipjan dhe objekti QMF-së në fshatin Shalë

### II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë

### II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Kontrate publike kornizë me disa operator

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

### II.1.5) Përshtkim i shkurtër i lëndës së kontratës

Rrënimi i objekteve të vjetra te tregu i gjebër në Lipjan dhe rrënimi i objektit të vjetër të QMF-së në Shalë. Të bëhet shkyqja nga kyqjet ekzistuese (rrjeti elektrik si dhe nga rrjeti hidrosanitar kanalizim), ne çmim perfshihe njoftimi I kompanive perqjegjese dhe perfillja e procedurave adekuate. Të bëhet rrënimi I objektit me dimisone 24 x 15 me forme te rregullt drejtkendeshë

